



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	06.07.2016
Referencë	11-344/6
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-QERSHOR

Pasqyra tabelare e punës për muajin –QERSHOR

DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar te punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktvendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme elokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore dhe bletarive	Mall me afat te skaduar	Biznese te paregjistrume,pa pranime teknike,per çmime
Biznesit	434	27	6	4	15	61			51			8	65	170	13					24
Ambientit	247	28							113					94			12			
Bujqësisë	238	4				7			52					137				38		
Ndërtimtarisë	219	31		4					51				1	132						
Trafikut	338	26		2		59			22		100	8	1	58			62			
Sanitar	201	18		3	43	27			26	1				50	2	31				
Gjithsejtë	1677	134	6	13	58	154			315	1	100	16	67	641	5	31	74	38		24

Gjatë muajit Qershor është punuar intenzivisht rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjeno-sanitare, kemi kontrolluar marketet ushqimore dhe depot ushqimore rreth aftashmërisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mallë dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, krahasimin e çmimeve të produkteve të ekspozuara me ato të arkës, kalibrimin e peshoreve etj.

Kemi pasur një aksion me njësitin Policor për Krime Ekonomike, Inspektoret e Administratës Tatimore, Inspektoret e Punës për kontrollimin e hotelerisë gjatë natës në regjionin e Prishtinës. Gjithashtu kemi mbyllur tri biznese për shkak mos respektimit të urdhëresave të dhëna me procesverbal, si dhe janë përpiluar fletëparaqitje ndaj bizneseve për mos respektim të ligjit.

Gjatë një aksioni në njërin prej marketeve kemi asgjësuar mallë në vlerë prej 41.79€. Në thertore jan inspektuar kafshët për therje, gjatë këtij muaji janë therë 31 shtazë në thertoren "Partner Kosova". Ndaj mos respektuesit të ligjit janë bërë kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar kompanitë e autobusëve në lidhje me rendin e udhëtimit se ajanë duke e respektuar atë rendë, po ashtu është bërë edhe inspektimi ia auto-taskive në rrugët e qytetit ku janë të vendosur, se mos po hasim ndonjë auto-taski që tentojnë të ushtron veprimtari ilegale

Në qytet është bërë edhe inspektimi i pjesës së rrugës "Hamz Jashari" ku gjatë punimeve për ndërtimin e objektit afaristo-banesor është bërë dëmtimi i kubzave gjatë bartjes-transportit se materialit ndërtimor ku është urdhëruar që të bëhet rregullimi menjëherë i asaj pjese të rrugës.

Po ashtu në këtë muaj kemi inspektuar vazhdimisht edhe në Aeroportin Ndërkombëtarë "Adem Jashari" në Vrellë,ku kemi bërë inspektimi në lidhje me auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtarin e auto-taksitë në mënyrë ilegale. Në koordinim të mirë punës kemi bërë me policin e Lipjanit për përndjekjen e auto taxiv ilegal.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar të gjitha guoret që veprojnë në territorin e komunës sonë, inspektimi është bërë me qëllim të verifikimit të dokumentacioneve që i posedojnë këto biznese, si Leja mjedisore nga MMPH, pëlqimin për ngastër nga komuna,sa sipërfaqe shfrytëzohet për biznes etj. Gjithashtu janë inspektuar edhe bizneset që shfrytëzojnë hapësirën publike në lidhje me lejen për shfrytëzim të kësaj pjese.

Është inspektuar në bazë të kërkesave të palëve si ne fshati. Babush i Muhaxhereve ku punë kryerësi Bechtel-Enka ka bërë dëmtimin e rretit të kanalizimit. Ai dëmtim i kanalizimit është sanuar mrenda dy ditëve me urdhër të inspektoratit. Inspektime në bazë të kërkesave të palëve janë bërë edhe në fshatrat Marec dhe Gllavice në lidhje me mbeturinat dhe plehrat e kafshëve.

Janë inspektuar deponite ilegale të mbeturinave si në qytet e fshatra dhe është inspektuar ndotja e mjedisit në përgjithësi.

Gjithashtu kemi filluar të bëjmë inspektimin e pishinave ne lidhje me higjienën, dokumentacionet dhe pastërtinë e ujit.

Janë kontrolluar disa shtëpi individuale të cilat janë pajis me leje ndërtimi.

Është duke u kontrolluar çdo pozicion i punës tek të gjitha objektet shumëkatëshe, duke mos i lejuar që ta hedhin betonin në vepër para se të kontrollohet plani i armaturës nga ana e Inspektoreve të Ndërtimit.

Janë larguar punëtorët nga punishtja në Gracke të Vjetër që kanë filluar të ndërtohen 2 shtëpi banimi si dhe është procedu lënda për gjykatë.

Pothuajse çdo dite gjatë këtij muaji është kontrolluar dhe janë larguar nga vendpunishta punëtorët të disa shtëpi që kane filluar të ndërtohen në afërsi të rrugës Sadik Shala në lagje të Akllapit si dhe është dërguar fletëparaqitje për kundërvajtje.

Është bërë inspektimi i objekteve afariste dhe banesore të cilat kanë filluar të ndërtohen gjatë ditëve të fundit, është ndërprë puna dhe janë larguar punëtorët nga vendpounishja të një objekti shumëkatësh i cili ka tentuar të ndërtoj në rrugën Shën Flori.

Pra në përgjithësi në muajin që e lamë pas kemi bere inspektimin e objekteve të cilat kane filluar të ndërtohen pa leje ndërtimi dhe ato të cilat kanë leje ndërtimi dhe janë në ndërtim e sipër.

Jemi munduar qe sa me shumë ta zbatojmë Ligjin e ndërtimit dhe udhëzimet Administrative te hyra ne fuqi ne vitin 2013.

Gjatë këtij muaji kami inspektuar dhe verifikuar fermerët që kanë aplikuar për Grande Komunale (Serr dhe Mjedra)

Të dhënat statistikore më të hollësishme janë të paraqitura në tabelën e më poshtme: